



**Lëmoshë
Për Kulturën:
MË PAK SE 1%
BUXHET**



RAPORT MONITORIMI
AUTOR
ILDA KURTI



www.qeverisja.qq.com.al



**RAPORT MONITORIMI MBI PRAKTIKAT E SHPENZIMEVE NË
MINISTRINË E KULTURËS
BUXHETI 2022**



Slogan¹ nga Ministria e Kulturës, '[Kultura 2022 Prioritet](#)'.

Autor: Ilda Kurti

Shkurt, 2022

¹ Ministria e Kulturës. Burimi:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=301323128692970&set=a.229475015877782>



Abstrakti

Ky raport ka si qëllim studimin e financimeve shtetërore në lëmin kulturor. Sektori kulturor në Shqipëri është lënë në harresë sa i përket financimit nga politikat shtetërore. Hulumtimi është i fokusuar në analizimin e politikave publike që janë zhvilluar nga institucionet kulturore. Ministria e Kulturës së Shqipërisë është institucioni qendror përgjegjës për ndërmarrjen e nismave për zhvillimin e politikave kulturore të qëndrueshme, që promovojnë diversitetin kulturor, duke shërbyer si rregullator dhe si inkurajues e financues i politikave kulturore në mbështetje të artit, institucioneve artistike dhe artistëve. Ky institucion ka detyrimin që të krijojë mekanizmat e duhur ligjorë në mbështetje të artit dhe kulturës, duke imponuar standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare në mbështetje të profesioneve krijuese. Krijimi i një politike qendrore kulturore, kërkon para për zbatimin praktik. Buxheti i kulturës në Shqipëri është i pamjaftueshëm. Për sa kohë që sektori kulturor nuk kalon pragun minimal të një përqindëshit, kultura do të vijojë të trajtohet me lëmosha, duke pamundësuar krijimin e një mjedisi favorizues për rritjen dhe zhvillimin e sektorëve kulturorë autonomë në vend.

Fjalë çelës: *buxheti, kultura, Ministria e Kulturës, politika kulturore, financime*



► PËRMBAJTJA E RAPORTIT

ABSTRAKTI

1. Shqyrtimi i literaturës dhe metodologjisë
2. Buxheti i Kulturës ndër vite
3. Pamjaftueshmëria e buxhetit
4. Financimi i projekteve kulturore
5. Komunikatë nga institucionet qendrore dhe vendore
6. Reagime nga Skena e Pavarur Kulturore
7. Efekti i pandemisë në sektorin kulturor në rajon dhe në botë

REKOMANDIME

BIBLIOGRAFIA

► Shqyrtimi i literaturës dhe metodologjisë

Studimi, gjykimi dhe klasifikimi i praktikave kulturore shtetërore në të mira dhe të këqija nuk mund të bëhet asesi, pa patur si bazë të pagabueshme financimin nga buxheti shtetëror. Investimi në politikat kulturore kombëtare është i paçmueshëm, qoftë për individët, qoftë edhe për subjektet. Shtetet e zhvilluara investojnë shumë para në sektorin kulturor, pasi arti dhe kultura shënjojnë një mision thellësisht edukues tek publiku, duke ndihmuar në rritjen e përgjithshme të mirëqënies shoqërore.

Në Republikën e Shqipërisë, institucioni më i lartë që përkujdeset për krijimin e politikave kulturore kombëtare është Ministria e Kulturës. Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave, numër 507, të datës 13.09.2017, "[Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Kulturës](#)", saktësohen veprimtaritë që ky institucion duhet të ushtrojë. Pika e dytë e kësaj VKM-je thotë se kryen: "Hartimin dhe bashkërendimin e punës për politikën në fushën e artit e të kulturës, nëpërmjet edukimit të popullsisë, rijetësimin të vlerave e të trashëgimisë kulturore, nxitjes së investimeve, publike dhe private, në këta sektorë, monitorimit të mënyrës së përdorimit të fondeve publike në mbështetje të zhvillimit kulturor, edukimit në kulturë, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, ruajtjes dhe vijimësisë së traditës së harmonisë fetare në kulturën shqiptare si dhe të bashkëpunimit rajonal."²





Foto ilustruese e VKM-së Nr. 507, Datë 13.09.2017, "[Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Kulturës](#)."

² Këshilli i Ministrave. "Vendim Nr. 507, Datë 13.09.2017, Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Kulturës." Burimi: <https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/VKM-per-fushen-e-pergjegjesise-se-Ministrise-se-Kultures.pdf>



Ky raport monitorimi është bazuar në metodologji hulumtuese cilësore, ku janë marrë në shqyrtim një sërë dokumentash të aksesueshme në faqet zyrtare të institucioneve në vend, nëpërmjet hulumtimit kompjuterik. **Të dhënat studimore në fushën e kulturës janë të pakonsiderueshme, thuajse nuk ekzistojnë, duke e vështirësuar disi zhvillimin e këtij raporti monitorues.**

Për mua si hulumtuese, është shqetësuese të shihet se sa pak të dhëna konkrete paraqiten përpara publikut, duke na rikujtuar se transparenca dhe llogaridhënia institucionale është minimale.


Mungojnë të dhënat bazë, ndërkohë që politikat e ndjekura duhet të ndjekin një metodologji strikte, e cila i lejon që të kenë një impakt të matshëm të suksesit ose mosp suksesit të tyre, që të justifikojnë në mënyrë shteruese motivet se përse është parë e arsyeshme për t'u ndjekur ajo rrugë.

Politikat kulturore nuk mund të ndiqen vetëm si vullnet vetjak i një individi apo grupi individësh që janë në pozicione drejtuese, por duhet që nëpërmjet evidencave shkencore dhe statistikave kombëtare të identifikojnë problematikat e sektorit, për të dhënë një zgjidhje gjithëpërfshirëse dhe me një impakt afatgjatë.

Ministria e Kulturës është duke implementuar "[Strategjinë Kombëtare për Kulturën 2019-2025](#)". Në këtë strategji, është vetë Ministria e Kulturës që identifikon [problemet dhe sfidat e sektorit të kulturës](#)³:

1. Shteti financuesi kryesor i institucioneve kulturore dhe operatorëve të pavarur.
2. Zbatimi dhe ndërgjegjësimi për kuadrin rregullator.
3. Kapacitetet njerëzore të institucioneve kulturore dhe operatorëve të pavarur.

³ Ministria e Kulturës. "Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025". Burimi: <https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/finale-Strategjia-Komb%C3%ABtare-p%C3%ABr-Kultur%C3%ABn-2019-2025.pdf> Fq. 17-22.

- 
4. Institucionet kulturore jashtë normave standarde.
 5. Bashkëpunimi i pamjaftueshëm mes institucioneve qendrore dhe vendore.
 6. Përcaktimi i Industrisë Kulturore dhe Krijuese në Shqipëri.
 7. Sistemi i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës statistikor.
 8. Teknologjia digjitale në produktet dhe shërbimet kulturore.

Në vetvete kjo lloj qasjeje institucionale është pozitive pasi mëton të krijojë një vizion afatgjatë për kulturën, përtej mandateve qeverisëse, por problemi qëndron se ka patur edhe të tjera strategji të mëherëshme që ky institucion ka ndjekur, për të cilat nuk janë publikuar rezultatet që kanë mbërritur.

Ministria e Kulturës dhe institucionet e saj të varësisë duhet të përmirësojnë nivelin e transparencës përballë publikut, ku studimet dhe informacionet e tjera me të dhëna statistikore të jenë lehtësisht të shfletueshme nga publiku nëpër sitet e tyre zyrtare në internet. Është e papranueshme që institucioni përgjegjës për mbarëvajtjen e sektorit kulturor të tregohet neglizhent në studimin e përditësuar të situatës.

Gjithashtu, në studimin e rastit të Shqipërisë, do të këshillohej që [Instituti i Statistikave](#) të pasqyronte raporte më të thelluara përreth Statistikave të Kulturës, por mbetet për t'u vlerësuar qasja e tyre pozitive për të bërë një studim të përgjithshëm të situatës kulturore në vend.

Po ashtu, në nivel ndërkombëtar, ka shumë pak qasje studimore ndaj Shqipërisë. UNESCO, agjencia e specializuar e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën, organizmi shkencor më i lartë në nivel ndërkombëtar, numëron fare pak studime apo raporte monitoruese për Shqipërinë. Kjo është një e dhënë dëshpëruese për kulturën shqiptare pasi niveli i tyre i lartë i ekspertizës do të ndihmonte shumë institucionet kulturore në vend.

4.2.2 Legal framework and support systems

- Law on sponsorship not as effective even if Opera House seems to be doing well.
- Access to EU funding made difficult because of legal requirements requested by Albanian administration; consider topping up co-funding requirement imposed by Creative Europe in some situations to encourage leadership and vision (today not possible).
- Collective management organization to improve royalty distribution.
- Little incentives for cultural institutions to develop revenue streams as box office and other receipts are given back to State budget.
- Cultural institutions not entitled to make scientific publications (problem of status).
- No specific policy to support development of culture and creative industries.
- Enforcement of intellectual property law. Level of piracy discourages investment in IP products and services.

4.2.3 Cultural institutions and management

- Extreme reliance on State budget (with little funding) for main cultural institutions.
- Dramatic underfunding (the Ministry's budget and staffing is a third of the budget in Georgia for instance).
- Need for clear criteria and their application for subsidy allocation (e.g. relevance for social/cultural debates and emancipation; audience attention; international recognition; international touring; participation in collaborations, awards; regional co-operation; etc).
- Private consumption in culture is to be developed to attract the younger generation.
- Lack of performance indicators for cultural institutions.
- No flagship cultural event or festivals with international reputation.
- Lack of storage space at National Library, National Film Archive and National Theatre.
- Lack of professional actors (Theatre).
- Lack of training in cultural assets management (no Master Degree in cultural management in business schools or universities).
- Legal framework to incentivise sponsorship, patronage to be developed.

Foto ilustruese e raportit, " [A Cultural Strategy for Albania. Implanting the Cultural Bug.](#)" Fq. 12.

Ndër analizat më të thelluara që i është bërë sektorit kulturor në Shqipëri, është analiza e quajtur "Një Strategji Kulturore për Shqipërinë. Vendosija/Mbjellja e çimkës kulturore." [Titulli në origjinal: [A Cultural Strategy for Albania. Implanting the Cultural Bug.](#)]⁴ ndërmarrë nga Këshilli i Europës, zhvilluar nga Philippe

Kern në mars të vitit 2018. Ky raport liston në një analizë të detajuar të gjithë pikat e dobta të sektorit kulturor, ku i grupon ato në pesë kategori kryesore: qeverisja politike dhe lidhshipi, korniza ligjore dhe sistemet mbështetëse, institucionet kulturore dhe menaxhimi i tyre, kultura dhe industria krijuese, si dhe bashkëpunimet ndërkombëtare.

Pos të tjerash, raporti ynë monitorues ka marrë gjithashtu në shqyrtim raportimet mediatike kombëtare dhe ndërkombëtare, për të dhënë një pasqyrim sa më të plotë të situatës në sektorët kulturorë. Këta artikuj mbushin disi vakumin që krijon mungesa e theksuar e statistikave kombëtare, rajonale apo edhe mbarëbotërore.

⁴ Kern, Philip. "Një Strategji Kulturore për Shqipërinë. Vendosija/Mbjellja e çimkës kulturore." [Titulli në origjinal: *A Cultural Strategy for Albania. Implanting the Cultural Bug.*]. Këshilli i Europës. Mars, 2018. Burimi: <https://rm.coe.int/a-cultural-strategy-for-albania-implanting-the-cultural-bug/1680794665>

► Buxheti i kulturës ndër vite

Në raportin e publikuar nga Ministria e Financave, “Buxheti 2022. Një vështrim për qytetarët”⁵ jepet një shpjegim i përgjithshëm, ku thuhet se: “Shpenzimet Buxhetore për periudhën 2022-2024 do të mbështesin një nivel të lartë investimesh publike, duke u përqëndruar në procesin e rindërtimit, si dhe financimin e projekteve të rëndësishme strategjike. Shpenzimet e planifikuara synojnë finalizimin e projekteve të rrugëve kombëtare, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural.”⁶

Në këtë raport thuhet shprehimisht se **prioritet mbetet financimi i projekteve të rëndësishme strategjike, por lihet pa përmendur sektori kulturor, duke lënë të kuptohet se nga pikëpamja buxhetore sektori kulturor është dytësor në parashikimet e këtij dyvjeçari.**

Në po të njejtin raport jepen shpenzimet buxhetore sipas funksioneve të qeverisë, ku zërit ‘*argëtimi, kultura dhe*

Ku shkojnë paratë e buxhetit të shtetit?




Foto e marrë nga raporti “Buxheti 2022. Një vështrim për qytetarët.”¹ Burimi: [Ministria e Financave dhe Ekonomisë](#)



Foto ilustruese e raportit: “Buxheti 2022. Një vështrim për qytetarët”. Burimi: [Ministria e Financave dhe Ekonomisë](#)

⁵ Ministria e Financave dhe Ekonomisë. “Buxheti 2022. Një vështrim për qytetarët”. Burimi: <https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/Buxheti-per-Qytetaret-2022.pdf>

⁶ Ministria e Financave dhe Ekonomisë. “Buxheti 2022. Një vështrim për qytetarët”. Fq. 5. Burimi: <https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/Buxheti-per-Qytetaret-2022.pdf>

feja" i akordohen 8,263 milionë lekë, apo 1.3% nga totali i shpenzimeve buxhetore sipas funksioneve të qeverisë.

► Pamjaftueshmëria e buxhetit

Ndarja e buxhetit të shtetit ndërmjet institucioneve u paraqit me tone brohoritëse në media pasi ndër ato ministri që kishte përfituar rritje të fondeve ishte edhe kultura. Ministrisë së Kulturës iu rritën fondet me +1.246 miliardë lekë "me synim restaurimin dhe mirëmbajtjen e trashëgimisë arkitektonike dhe peizazhit, duke përfshirë restaurimin e disa linjave muzeale, si dhe përshtatjen me standarde bashkëkohore, po ashtu synohet edhe rritja e numrit të visitorëve nëpër muze dhe zonat e trashëgimisë kulturore."⁷

A ishte kjo një rritje domethënëse për politikën kulturore?

Pak ditë më pas, ministrja e Kulturës, Elva Margariti deklaroi se "buxheti 2022 për Kulturën është rritur në një masë të paprecedent prej 46.6% krahasuar me një vit më parë."⁸

⁷ Shqiptarja.com. "Si ndahet buxheti 2022 mes institucioneve? Shëndetësia merr pjesën e luanit! Tkurren fondet për Infrastrukturën dhe Financat." Tetor 27, 2021. Burimi:

<https://shqiptarja.com/lajm/si-ndahet-buxheti-2022-mes-institucioneve-shendetesia-merr-pjesen-e-luanit-tkurren-fondet-per-infrastrukturen-dhe-financat>

⁸ Agjencia Telegrafike e Lajmeve. "Margariti për projektet në buxhetin 2022: Prioritet Teatri i ri." Nëntor 02, 2021. Burimi: <https://ata.gov.al/2021/11/02/margariti-per-projektet-ne-buxhetin-2022-prioritet-teatri-i-ri/>

Në një analizë të sajën të mëhershme, Ministria e Kulturës pohon në [“Strategjinë Kombëtare për Kulturën 2019-2025”](#) se buxheti i saj është më i ulëti. Në tabelën⁹ shoqëruese mund të ndiqet buxheti për vitet 2013 deri në vitin 2018. Në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto, buxheti për kulturën është vërtitur tek përqindjet 0.10%-0.13%, i cili është tepër larg nga pragu minimal prej 1% që këshillohet për kulturën.

Ministria po ashtu pohon se institucionet e saj të varësisë thithin rreth 50% të buxhetit, dhe vetëm pjesa e mbetur mund të përdoret për të realizuar aktivitete kulturore apo thirrje për projekte.

Vitet	Shuma në Lekë	Përqindja në raport me PBB-në
2013	1,422,912	0.10%
2014	1,516,000	0.11%
2015	1,487,160	0.10%
2016	1,654,309	0.11%
2017	1,687,900	0.11%
2018	2,090,000	0.13%


Tabela 6.

Sot Ministria e Kulturës ka buxhetin më të ulët nga të gjitha ministrinë e linjës, me 2,165,867,000 Lekë për vitin 2019, apo 0,68% të buxhetit shtetëror. Në varësi të saj ka 28 institucione të fushës së artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore të cilat thithin rreth 50% të buxhetit, ndërkohë që pjesa tjetër shfrytëzohet për realizimin e aktiviteteve të organizuara nga MK si dhe operatorët e pavarur përmes projekteve me thirrje.

[“Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025”](#)

Edhe në njërin prej raporteve të auditimit që Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer për Institutin e Monumenteve të Kulturës në maj 2020, institucion ky i varur nga Ministria e Kulturës, konstatohet se fondet në dispozicion të institucionit janë

⁹ Ministria e Kulturës. “Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025”. Burimi: <https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/finale-Strategjia-Komb%C3%ABtare-p%C3%ABr-Kultur%C3%ABn-2019-2025.pdf> Fq. 15.



kryesisht në zërin shpenzime personeli, mallra dhe shërbime. Mandej në analizë thuhet: “Nga auditimi konstatohet se projekt buxhetet e hartuara dhe zbatuara nuk janë në korelacion të drejtë me nevojat reale të institucionit, për përmbushjen e objektivave dhe detyrave themelore të tij. **Buxhetet e mësipërme përmbushin nevojat elementare të funksionimit të institucionit, por jo përmbushjen e veprimitarisë së tij.**”¹⁰

Ky përfundim i KLSH-së mundet lehtësisht të aplikohet tek të gjithë institucionet e varësisë që Ministria e Kulturës ka. Fakti pse nëpërmjet buxhetit të shtetit ato arrijnë të shlyejnë detyrimet kundrejt punonjësve dhe shpenzimeve të tjera të tyre, kjo do të thotë se aq edhe më i paktë është fondi që mbetet për t'u investuar në mbështetjen e projekteve kulturore. Pra, institucionet vetëm sa arrijnë të “mbahen në këmbë”, sepse në të vërtetë nuk kanë hapësirën më minimale për të financuar misionin e tyre në skenën e pavarur kulturore. Mungesa e financimit të sektorit kulturor, ka bërë që shpeshherë artistët të kërkojnë [ritje të buxhetit për artin dhe kulturën](#).¹¹

¹⁰ Kontrolli i Lartë i Shtetit. “Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në ‘Institutin e Monumenteve të Kulturës. Maj 2020. Fq. 21.

¹¹ Sot. “Artistët përballë Kumbaros dhe Margaritit, kërkojnë rritje buxheti për artin e kulturën, status për universitetin dhe rikthim të QKA.” Janar 12, 2019. Burimi: <https://sot.com.al/kultura/artistet-perballe-kumbaros-dhe-margaritit-kerkojne-rritje-buxheti-artin-e-kulturen-status>

Për periudhën 2020-2022, shpenzimet buxhetore të Ministrisë së Kulturës për të përmbushur objektivat e synuar paraqiten sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela 25: Shpenzimet për Ministrinë e Kulturës për vitet 2020-2022

Shpenzimet për Ministrinë e Kulturës në vlerë nominale (në milion lek) dhe në % ndaj PBB 2020-2022				
	Shpenzimet totale			
	Buxheti 2019	PBA 2020	PBA 2021	PBA 2022
Kultura (në milion/lek)	2,166	2,015	2,025	2,027
<i>Nga të cilat: projekte me thirrje (arti dhe kultura)</i>	137.3	141.5	144.9	145.4
Në % ndaj PBB	0.12%	0.11%	0.10%	0.10%
Në % ndaj Shpenzimeve të Përgjithshme të Qeverisë	0.42%	0.37%	0.35%	0.33%

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka publikuar 'Programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022', ku përveç synimeve të institucionit për t'i përmbushur në dyvjeçarën e ardhshëm, pasqyrohet edhe një tabelë me shpenzimet në vlerë nominale dhe në përqindje ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto.

Tabela paraqet një krahasim të katërvjeçarit të fundit të shpenzimeve të Ministrisë së Kulturës kundrejt prodhimit të brendshëm bruto (PBB). Përqindja e buxhetit të vitit 2019 është 0.12%, e cila zvogëlohet në 0.11% në vitin 2020 dhe edhe më për vitin 2021, në 0.10% dhe po aq ka mbetur edhe për vitin 2022.

Tabela 26: Shpenzimet për Ministrinë e Kulturës sipas programeve buxhetore dhe sipas artikujve ekonomikë

Emërtimi i Njesisë së Qeverisjes Qendrore	MINISTRIA E KULTURËS			
Përmbledhje e vlerësimeve trevjeçare				
(in 000' LEK)	2019 Buxheti	2020	2021	2022
		PBA	PBA	PBA
Klasifikimi funksional I shpenzimeve				
Total	2,165,867	2,015,000	2,025,000	2,026,500
Planifikimi menaxhimi administrimi	160,276	170,000	185,000	185,500
Trashëgimia kulturore	522,191	567,500	557,500	558,000
Arti dhe kultura	1,483,400	1,277,500	1,282,500	1,283,000
Klasifikimi ekonomik I shpenzimeve				
Total	2,165,867	2,015,000	2,025,000	2,026,500
600. Pagat	822,689	822,809	822,809	822,809
601. Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore	138,311	138,191	138,191	138,191
602. Mallrat dhe shërbimet	321,698	332,031	353,631	349,631
603. Subvencionet	-	-	-	-
604. Transfera të brendshme	170,088	211,200	199,600	205,100
605. Transfera të jashtme	8,081	10,589	10,589	10,589
606. Transfera për familjet dhe individët	-	180	180	180
230. Aktivitet e patrupëzuara	-	20,000	-	-
231. Aktivitet e trupëzuara	705,000	480,000	500,000	500,000

Mandej Ministria e Financave e vijon mandej raportin me detajimin e shpenzimeve të Ministrisë së Kulturës, dhe nëse bëhet një krahasim me totalin, institucioni shpenzon më shumë se gjysmën e buxhetit për mbulimet e pagave dhe sigurimeve të punonjësve.

Ministria e Kulturës ka të publikuar online "[Detajimin e Buxhetit të Vitit 2022 për Institucionet e Varësisë të MK](#)". Totali është 1,516,500,000 lekë¹². Ky buxhet shpërndahet më pas për Aparatin e Ministrisë së Kulturës, Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit, Teatrin Kombëtar, Bibliotekën Kombëtare, Galerinë e Arteve, Arkivin Qendror të Filmit, Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, dhe gjithë institucionet e tjera të varësisë.

¹² Ministria e Kulturës. "Detajimi i Buxhetit të Vitit 2022 për Institucionet e Varësisë të MK". Burimi: https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2020/05/Detajim-Buxheti-Korrente-2022_MK.pdf

MINISTRIA E KULTURES
 Detajimi i Buxhetit te Vitit 2022 per Institucionet e varesise te M.K
 Tabela 1

Tipi i Qeverisjes	Minist. Linjes	Institucioni	Emri i Institucioni	Kapitull	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi i Qarkut (Dega Thesarit)	Kodi Produktit	Emertimi i produktit	Detajim Buxheti 2022 ne leke
001	12	1012001	Aparati MK	01	01110	6000000	3535	91201AA	Akte ligjore/nenligjore te miratuara	97,676,000
001	12	1012001	Aparati MK	01	01110	6010000	3535	91201AA	Akte ligjore/nenligjore te miratuara	17,600,000
001	12	1012001	Aparati MK	01	01110	6020000	3535	91201AB	Stafi trajnuar	60,044,000
001	12	1012001	Aparati MK	01	01110	6060000	3535	91201AB	Stafi trajnuar	180,000
001	12	1012024	Teatri Komb. i Operas dhe Baletit	01	08230	6000000	3535	91203AA	Premiera dhe shfaqje artistike te zhanrit skenik operistik, koreografik dhe folklorit kombetar.	224,430,000
001	12	1012024	Teatri Komb. i Operas dhe Baletit	01	08230	6010000	3535	91203AA	Premiera dhe shfaqje artistike te zhanrit skenik operistik, koreografik dhe folklorit kombetar.	37,468,000
001	12	1012024	Teatri Komb. i Operas dhe Baletit	01	08230	6020000	3535	91203AA	Premiera dhe shfaqje artistike te zhanrit skenik operistik, koreografik dhe folklorit kombetar.	15,000,000
001	12	1012024	Teatri Komb. i Operas dhe Baletit	05	08230	6020000	3535	91203AA	Premiera dhe shfaqje artistike te zhanrit skenik operistik, koreografik dhe folklorit kombetar.	2,900,000
001	12	1012024	Teatri Komb. i Operas dhe Baletit	01	08230	6040000	3535	91203AA	Premiera dhe shfaqje artistike te zhanrit skenik operistik, koreografik dhe folklorit kombetar.	19,000,000
001	12	1012024	Teatri Komb. i Operas dhe Baletit	01	08230	6050000	3535	91203AA	Premiera dhe shfaqje artistike te zhanrit skenik operistik, koreografik dhe folklorit kombetar.	500,000
001	12	1012022	Teatri Kombetar	01	08230	6000000	3535	91203AB	Premiera dhe shfaqje artistike te zhanrit skenik teator klasik dhe bashkekohor.	57,574,000
001	12	1012022	Teatri Kombetar	01	08230	6010000	3535	91203AB	Premiera dhe shfaqje artistike te zhanrit skenik teator klasik dhe bashkekohor.	9,600,000
001	12	1012022	Teatri Kombetar	01	08230	6020000	3535	91203AB	Premiera dhe shfaqje artistike te zhanrit skenik teator klasik dhe bashkekohor.	13,500,000
001	12	1012022	Teatri Kombetar	05	08230	6020000	3535	91203AB	Premiera dhe shfaqje artistike te zhanrit skenik teator klasik dhe bashkekohor.	3,000,000
001	12	1012022	Teatri Kombetar	01	08230	6040000	3535	91203AB	Premiera dhe shfaqje artistike te zhanrit skenik teator klasik dhe bashkekohor.	13,000,000


Ajo qe te bie me shume ne sy nga ky raport eshte thuktesia e informacionit dhe zerat kaq te gjerë qe shpjegojnë se perse do te perdoren keto para. **Duket paradoksale disi qe një dokument qe shkruan “buxhet i detajuar”, të mos përfshijë asnjë detajim mbi shpenzimet e parashikuara për secilin nga këto institucione.** Duhet t'i jepet fund metodave të së shkruarit të disa dokumenteve kallpe qe s'thonë asgjë konkrete. Kërkohet me ngulm qe të rritet transparenca në lidhje me parashikimet buxhetore!

Shpenzimet Publike për Argëtim, Kulturë dhe Çështje Fetare

Ky seksion paraqet të dhëna në lidhje me shpenzimet publike për fushën Argëtim, Kulturë dhe Çështje fetare. Këto shpenzime, ndër të tjera përbëjnë rëndësi për konsolidimin dhe promovimin e vlerave artistike, artit dhe aktiviteteve kulturore në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në 2020, shpenzimet publike në këtë fushë kanë qenë 6.842 mln lekë. Këto shpenzime përbëjnë 1,3 % të shpenzimeve publike gjithsej për vitin 2020 dhe zënë një peshë prej 0,4 % në PBB-në gjithsej. Krahasuar me vitin 2019, shpenzimet publike në Argëtim, Kulturë dhe Çështje fetare shprehur si përqindje ndaj PBB nuk kanë ndryshuar, ndërkohë shpenzimet publike shprehur si përqindje ndaj shpenzimeve publike gjithsej, kanë shënuar rënie me 0,2 pikë përqindje.

Fig. 9 Shpenzimet publike për argëtim, kulturë dhe çështje fetare, (në %)



* Të dhënat janë gjysëm-finale

** Të dhënat janë bazuar në vlerësimet tremujore

Në raportin “[Statistika të Kulturës, 2020](#)”, sipas përlllogaritjes së INSTAT: “Në 2020, shpenzimet publike në këtë fushë kanë qenë 6.842 mln lekë. Këto shpenzime përbëjnë 1.3% të shpenzimeve publike gjithësej për vitin 2020 dhe zënë një **peshë prej 0.4% në PBB-në gjithësej.**”¹³

Gazetarja Elsa Demo u shpreh në emisionin televiziv Artes, ‘[Arti nën patronazh](#)’ “Ne dimë që Ministria e Kulturës gjatë gjithë historisë së saj ka patur buxhetin më të ulët në krahasim me ministrinë e tjera të linjës. Nga 2013, të dhënat që kemi ne, rritja ka qenë pothuajse e papërfillshme. Në 2013 shkon në 0.10% të prodhimit të brendshëm bruto dhe aktualisht jemi në vlerën 0.68%.”¹⁴

Meri Kumbi, zëvendësministrja aktuale e Kulturës u shpreh se në fushën e projekteve kulturore, “Njohim një rritje me 288% krahasuar me ç’ka qenë përpara. Në sektorin e projekteve artistike kemi një rritje prej 443 milionë lekë, nga 165 që ka qenë në vitin 2021, rreth 200 milionë në vitin 2020 dhe 190

¹³ INSTAT. “Statistika të Kulturës, 2020.” Fq. 9. Burimi: <http://www.instat.gov.al/media/8573/statistika-te-kultures-2020.pdf>

¹⁴ Artes nga Elsa Demo. “Arti nën patronazh”. YouTube video, 01:18. RTSH, Shkurt 2, 2022. <https://www.youtube.com/watch?v=YYjtxj4fqjo> (aksesuar më 10 shkurt 2022).

milione në vitin 2019.”¹⁵ Mandej ka vijuar të tregojë se “Kultura për këtë mandat është kryefjalë e mandatit të tretë të qeverisë Rama.”¹⁶

Panelistët e tjerë kanë replikuar ndaj deklaratës së zëvendësministres, duke u shprehur se rritja e borxhit publik nuk duhet të rëndojë mbi kulturën pasi borxhi i deriatëhershëm nuk është marrë për shkak të kulturës.

Aktivisti dhe menaxheri i kulturës, Andi Tepelena, replikoi ndaj zv. Kumbe dhe në një qasje krahasuese me Kosovën, tha se “Vetëm fondin për projekte [Kosova] e ka 3.8 milionë euro fondin për projekte për kulturën dhe vetëm për muzikën klasike e ka 400 mijë euro. Kosova është me një buxhet dy herë më të ulët se sa Shqipëria, por e ka fondin për kulturën më të lartë se sa Shqipëria. 1 milionë e gjysëm euro është buxheti i filmit. Fondi total për kulturën, ai që menaxhohet nga Ministria e Kulturës është rreth 13-14 milionë euro, që do të thotë është e barazvlefshme me 1 kilometër e gjysëm, apo 2 kilometra rrugë rurale. Ky është interesi, apo vullneti politik për të mbështetur kulturën. [...] Rritja me 1% jo vetëm është i mundshëm, po kjo i kthehet ekonomisë shqiptare, [...] sepse forcohet industria kulturore dhe i kthehet e gjitha ekonomisë.”¹⁷

Burime të ndryshme japin përqindje të ndryshme, por me një mesatare mund të themi se shifrat e buxhetit të kulturës vërtiten tek 0.10% në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto. Duhet përafërsish dhe 9 herë më shumë ky buxhet që ka qenë, për të arritur pragun minimal prej 1% të PBB-së për kulturën.

¹⁵ Artes nga Elsa Demo. “Arti nën patronazh”. YouTube video, 05:10. *RTSH*, Shkurt 2, 2022. <https://www.youtube.com/watch?v=YYjtxj4fqjo> (aksesuar më 10 shkurt 2022).

¹⁶ Artes nga Elsa Demo. “Arti nën patronazh”. YouTube video, 06:25. *RTSH*, Shkurt 2, 2022. <https://www.youtube.com/watch?v=YYjtxj4fqjo> (aksesuar më 10 shkurt 2022).

¹⁷ Artes nga Elsa Demo. “Arti nën patronazh”. YouTube video, 12:58. *RTSH*, Shkurt 2, 2022. <https://www.youtube.com/watch?v=YYjtxj4fqjo> (aksesuar më 10 shkurt 2022).

► **Financimi i projekteve kulturore**

Në vijim të deklaratës pozitive të zv. ministres Kumbi, kemi qëndruar në pritje të deklaratave zyrtare nga Ministria e Kulturës në lidhje me financimet për projektet për vitin 2022.




Foto e ministres Elva Margariti. Burimi: [Ministria e Kulturës](#)

Projektet kulturore kanë shënuar numrin më të madh të aplikimeve, sipas një [deklarate](#) të Ministrisë së Kulturës në rrjetet sociale, "si asnjëherë më parë u depozituan 500 projektpropozime në fushën e artit, trashëgimisë e digjitalizimit, prej nga u përzgjodhën 185 syresh, që do të financohen nga buxheti i këtij viti. Është ky numri më i madh i fituesve që ka shpallur MK që prej vitit 2014 e që ka një larmishmëri zhanresh, por edhe shtrirjeje gjeografike nga Veriu në Jug. Duke parë numrin e madh të aplikimeve të artistëve të rinj, me projekte teatrore, vendosëm t'i orientojmë ato në Fondin e Teatrit të të Rinjve."¹⁸

¹⁸ Ministria e Kulturës. Burimi: https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=317364217088861&id=100064458561129

Mandej është vënë në dispozicion të publikut lista¹⁹ e [185 subjekteve fituese](#), me projektet fituese përkatëse. Prapseprap, transparencja financiare nuk është bërë publike. Për asnjërin nga këto projekte nuk bëhet me dije se sa para do të financohen nga buxheti i shtetit dhe as nuk jepet një shifër totale për financimin e të 185 projekteve.

Bashkëngjitur po paraqesim një raport pasqyrë të projekteve të financuara përgjatë viteve 2014-2018.²⁰



¹⁹ Ministria e Kulturës. “Lista e 185 Fituesve të Thirrjes për Projekt-Propozime 2022.” Burimi: <https://drive.google.com/file/d/1uZTFBGA45ZkIk9ep1BOoHmWjMkBILE2i/view>

²⁰ Ministria e Kulturës. “Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025.” Burimi: <https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2019/09/Strategjia-Komb%C3%ABtare-p%C3%ABr-Kultur%C3%ABn-2019-2025.pdf> Fq. 16-17.


Komunikatë nga institucionet qendrore dhe vendore

Në mbyllje të vitit 2021, Qëndresa Qytetare depozitoi disa kërkesa për informacion për të mësuar më shumë se cilat do të ishin investimet e parashikuara për vitin 2022 në objekte kulturore dhe në aktivitetet kulturore.

Institucionet qendrore

Qëndresa Qytetare dërgoi kërkesa zyrtare për informacion pranë Ministrisë së Kulturës dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore.

Ministria e Kulturës në përgjigjen e saj rreshtoi 15 investime të parashikuara në objekte kulturore, po nuk dha asnjë përgjigje rreth aktiviteteve kulturore të planifikuara. Ndërsa pyestjes se nëse është parashikuar nisja e ndërtimit të Teatrit Kombëtar në vitin 2022 iu përgjigj me një pohim të thukët, pa dhënë anjë detaj më shumë rreth projektit.


REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 6632/prot. Tiranë, më 14.01.2022

Lënda: Kthim përgjigje

QËNDRESA QYTETARE
Rr.Hoxha Tahsim, Pall. "Vjetro", Ap.23A,
Tiranë

Në vijim të shkresës tuaj me datë 27.12.2021 mbi: "Kërkesë për Informacion", ju bëjme me dije se përgjigjet janë si më poshtë:

- 1) Cilat investime në objektet kulturore janë parashikuar nga Ministria e Kulturës për vitin 2022?
- 2) Cilat janë investimet në aktivitetet kulturore përgjatë vitit 2022

Përgjigja për pyetjen 1 dhe 2 është:

Investimet që janë parashikuar për vitin 2022 në objekte kulturore janë si më poshtë:

- Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i hapësirave në Muzeun e Arteve të Bukura (Galerisë Kombëtare të Arteve);
- Restaurimi për ndërtuesin e Fondit të Bibliotekës Kombëtare (Faza1)
- Restaurim Projektim dhe Implementim i Mozaikut, Tiranë;
- Rikonstruksion dhe Rinovim i sallës koncerteve në Universitetin e Arteve, Tiranë;
- Ndërtimi i Qendrës Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave;
- Rijetësimi i Piramidës, Tiranë;
- Godina e Teatrit, Tiranë;
- Projekti me Rajonin e Pullas për rikualifikimin e hapësirës së Parkut të Kinostudios "Parku Artisti";
- Resaturimi "Kisha e Shën Kollit", Krutje e Sipërme, Lushnje;
- Projekti Elektrik për ndriçimin e jashtëm, Kalaja e Beratit;

Adresa: Rruga Aleksander Moisiu, nr 76, ish Kinostudio "Shqipëria e Re," Tiranë
Nri tel: (04) 2271324, (04) 2222508 Email: info@kultura.gov.al www.kultura.gov.al

- Projekti Elektrik për ndriçimin e jashtëm, Kalaja e Krujës;
- Projekti Elektrik për ndriçimin e jashtëm, Kalaja e Shkodrës;
- Projekti Elektrik për ndriçimin e jashtëm, Kalaja e Gjirokastrës;
- Projekti IPA "Creatures promovimi i turizmit kreativ";
- Projekti IPA SMART CUL TOUR.

3) A është parashikuar nisja e ndërtimit të Teatrit Kombëtar në vitin 2022?

Nisja e ndërtimit të Teatrit Kombëtar është parashikuar për vitin 2022.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,


SEKRETAR I PËRGJITUSHËM


Foto e përgjigjes së Ministrisë së Kulturës.

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore po ashtu na ktheu një përgjigje pa përgjigje.

Përshëndetje,

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), me Nr.2133 Prot., datë 29.12.2021, lidhur me investimet e parashikuara ne objektet kulturore përgjate vitit 2022, ju bëjmë me dije se:

IKTK ka paraqitur në Projekt Buxhetin Afatmesëm (PBA) 2022-2024, një listë me projektet për investime nga Buxheti i Shtetit për vitin 2022.

Pas miratimit të Buxhetit të vitit 2022 për cdo Ministri, në IKTK deri më tani është hapur vetëm Buxheti i shpenzimeve korente.

Për shpenzimet kapitale/investimet, buxheti detajohet nga Ministria e Kulturës për institucionet e varësise, brenda muajit shkurt.


Sapo ky buxhet të ketë ardhur, IKTK e bën translarent për publikun në faqen zyrtare të saj.

Duke ju falenderuar,

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore

Foto e përgjigjes nga IKTK.


Nga verifikimi ynë i mëtejshëm, në programin e transparencës së këtij institucioni nuk duket të jetë publikuar asgjë në lidhje me buxhetin për vitin 2022 dhe as Projekt Buxheti Afatmesëm.



Pushteti vendor

Qëndresa Qytetare dërgoi kërkesa për informacion pranë 5 prej bashkive kryesore në vend: Bashkia Tiranë, Durrës, Fier, Krugë dhe Vlorë. Bashkia e Durrësit ishte e vetmja që iu përgjigj kërkesës tonë, duke na informuar se “bashkia ka miratuar në buxhetin e saj për vitin 2022 një fond me shumën 10.000.000 lekë i cili do të përdoret për veprimtaritë kulturore, artistike dhe sportive.” Sipas tyre, kalendari kulturor do të miratohet në mars 2022, pra rreth 3 muaj më vonë nga fillimi i vitit.





REPUBLIKA E SHqipëRIË
BASHKIA Durrës
DREJTORIA, ARSIM, KULTURË, RINI, SPORT, KOMUNITETE FETARE
SEKTORI I KULTURËS

Nr 13689 Prot Durrës, më 30 / 12 / 2021

Lënda: Kthim përgjigje Organizatës "Qëndresa Qytetare"

ORGANIZATËS "QËNDRESA QYTETARE"
Rr. "Hoxha Tasim", Pallati "Vjetro", Ap 23^e Tirane

Pasi morëm në shqyrtim shkresën tuaj të datës 27/12/2021 protokolluar me nr prot. 13689, datë 29/12/2021 drejtuar Institutionit tonë, mbi informacionin që ju kërkonti në lidhje me investimet kulturore në objekte dhe aktivitete kulturore përgjatë vitit 2022, ju sqarojmë se Bashkia jonë ka miratuar në buxhetin e saj për vitin 2022 një fond në shumën 10.000.000 lekë i cili do të përdoret për veprimtaritë kulturore, artistike dhe sportive.
Nderkaq veprimtaritë e karakterit të sipërpërmendur për vitin 2022 do të aprovohen nga Këshilli Kulturor në mbledhjen e parë të vitit 2022 ku do të shpallen edhe projektet fituese. Si rrjedhojë kalendari i veprimtarive artistike, kulturore dhe sportive do të shpallet në muajin mars 2022.
Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.


KRYETAR
Emjriana Sako
BASHKIA Durrës

L.gj. Nr. 1, Sheshi "Liria", tel& fax +355 52 2723 10, www.durres.gov.al, e-mail: info@durres

Përgjigjia e Bashkisë së Durrësit. Datë 30.12.2021.

Katër kërkesat e mbetura pa përgjigje janë ankimuar pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit. Gjithsesi, kjo mungesë transparence ndaj publikut tregon se sa prioritare është kultura për pushtetin vendor. Dritëshkurtësia e politikave të tyre kulturore ka impakt të drejtpërdrejtë tek qytetarët, pasi ua pamundëson edhe më qasjen drejt kulturës.

Reagime nga Skena e Pavarur Kulturore

Skena e Pavarur Kulturore është një grupim organizatash që ka shprehur në mënyrë aktive [reagime](#) kundrejt [pamjaftueshmërisë](#) së buxhetit për kulturën. Në vitin 2018, Skena e Pavarur Kulturore shpalli Manifestin "1% për Kulturën!"

1% PËR KULTURËN!

Manifest për Kulturën i Skenës së Pavarur Kulturore (SPK)

MANIFESTI PËR KULTURËN, në ndihmë të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm dhe kërkesës buxhetore për PBA 2019-2021, synon të vendosë Artin dhe Kulturën në Shqipëri në lartësinë e nismave dhe diskutimeve në nivel Europian mbi financimin e tyre - **“Supporting Europe is supporting Culture, 1% for Culture”**. Aktualisht arti dhe kultura përbëjnë vetëm 0.4% të buxhetit të shtetit, duke e renditur Shqipërinë të fundit në rajon dhe Europë.

Kjo nismë Europiane ndërmeret nisur nga principet që e bëjnë kulturën asetin më të rëndësishëm për ruajtjen dhe konsolidimin e identitetit kombëtar, forcon vlerat e demokracisë, edukon brezin e ri me vlerat kulturore europiane, nxit aktivizmin qytetar dhe zhvillon frymën e dialogut ndërkulturor, integron kategoritë në nevojë dhe zbut varfërinë, stimulon tolerancën, rrit mirëkuptimin dhe respektin për njeri-tjetrin, forcon kohezionin social, rrit solidaritetin dhe respektin diversitetet kulturore, rrit kapitalin social, punësimin në sektorin e kulturës dhe bëhet faktor zhvillimi ekonomik, nxit e përmirëson kapacitetet në industrinë krijuese dhe turizmin kulturor. ndërton ura midis vendeve të Bashkimit Europian dhe promovon respektimin e të drejtave të njeriut,

Në linjë me këtë nismë, aspirata e përbashkët e komunitetit të artit dhe kulturës në Shqipëri është **që** në 3-vjeçarin e ardhshëm, të ndërmerren politika që mundësojnë financimin e artit dhe kulturës në nivele të krahasueshme me rajonin dhe Bashkimin Europian. Kjo do të mundësojë që, sikurse dhe sektorët e tjerë, politikat për artin dhe kulturën të përafërohen me ato të BE-së.

“Manifest për Kulturën.” Burimi: Skena e Pavarur Kulturore

Ky reagim vinte si pasojë e një reforme kulturore europiane “Supporting Europe is supporting Culture. 1% for Culture.”

Në shkurt të 2021 deklaruan se: “Arti dhe Kultura përbëjnë vetëm 0.4% të buxhetit të shtetit, duke e renditur Shqipërinë të fundit në rajon dhe Europë. Aspirata jonë është që në 4 vjeçarin e ardhshëm të ndërmerren politika që sikurse edhe në sektorët e tjerë, edhe sektori i artit dhe kulturës të përafrohet me ato të BE-së. Kultura duhet parë si sektor prioritar në ekonominë shqiptare dhe buxheti i saj të rritet nga 0.4% në nivelin ambicioz të 1%.”²¹

²¹ Sot. “Shqipëria e fundit në Europë në buxhet për artin, SPK propozon rritje fondesh, krijim të QKA dhe regjistrin për IKK. Shkurt 25, 2021. Burimi: <https://sot.com.al/kultura/shqiperia-e-fundit-ne-europe-ne-buxhet-per-artin-spk-propozon-rritje-fon-i425695>



► Efekti i pandemisë në sektorin kulturor në rajon dhe botë

Nëse do të krahasonim nivelin e financimit të politikave kulturore shtetërore në Shqipëri, me ato në Kosovë apo gjetkë, do vërenim se bëhet fjalë për diferenca të disafishta, jo vetëm në buxhet, por edhe në qasjen kundrejt efekteve të pandemisë dhe paketave financiare lehtësuese për sektorin.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Kosovë [planifikoi](#) rritjen e buxhetit për Qendrën Kinematografike të Kosovës për vitin 2022 në 1,590,960 euro.²² Gjithashtu, në mbyllje të vitit 2021, ministri i Kulturës së Kosovës, Hajrulla Çeku u shpreh se kishin planifikuar për të rritur buxhetin për trashëgiminë kulturore dhe sportin në 5.4 milionë euro.²³

Në vitin 2019 Maqedonia numëronte një [buxhet 3 herë më të lartë se Shqipëria, me afërsisht 3.140.216.000 denarë, apo përafërsisht 50 milionë euro](#).²⁴ Buxheti i vitit 2020 u rrit në 3.462.483.000 denarë. Në vitin 2021 buxheti i Ministrisë së Kulturës ishte 3.276.430.000 denarë, dhe sipas raportimit në media²⁵, buxheti i vitit 2021 ishte zvogëluar dhjetë milionë denarë krahasuar me buxhetin e rritur të vitit 2020. Përkatësisht, në vitin 2020 janë mbështetur 3437 projekte dhe në vitin 2021 janë mbështetur 2254 projekte nga [Ministria e](#)

²² Kallxo. “Mbi katër milionë euro më pak buxhet për MKRS-në, në krahasim me vitin 2020.” Nëntor 01, 2021. Burimi: <https://kallxo.com/lajm/mbi-kater-milione-euro-me-pak-buxhet-per-mkrs-ne-ne-krahasim-me-vitin-2020/>

²³ KosovaPress. “Çeku bën bilancin e 2021: Rritëm buxhetin për trashëgiminë kulturore dhe sportin.” Dhjetor, 2021. Burimi: <https://kosovapress.com/ceku-ben-bilancin-e-2021-s-rritem-buxhetin-per-trashegimine-kulturore-dhe-sportin/>

²⁴ Probiznes. “Buxheti për kulturën i Maqedonisë 3 herë më lartë se ai i Shqipërisë.” Shkurt 28, 2019. Burimi: <https://probiznes.al/buxheti-per-kulturen-i-maqedonise-3-herë-me-larte-se-ai-i-shqiperise/>

²⁵ KDPolitik. “Maqedoni e Veriut: A do të rikuperohet kultura pas pandemicë?” Janar 05, 2022. Burimi: <https://kdpolitik.com/2022/01/05/maqedoni-e-veriut-a-do-te-rikuperohet-kultura-pas-pandemise/>



[Kulturës së Maqedonisë së Veriut](#), e cila vijon të ketë një buxhet kulturor 3 herë më të lartë se Shqipëria.

Qeveria e Republikës së Kroacisë²⁶ ka ndërmarrë një varg masash lehtësuese kundrejt sektorit kulturor, për të minimizuar sadopak pasojat e pandemisë. Fare pranë, më 22 janar 2022 u njoftua nga Zagrebi se Ministria e Kulturës dhe Medias²⁷ kroate ka miratuar rritjen e mbështetjes financiare në fushën e kulturës. Promovimi i arteve vizuale arriti në shumën totale 4.035 milionë kuna kroate, përafërsisht 553,000 Euro, me 214 projekte të financuara; ndërsa për shkrimin krijues dhe përkthimin u miratuan 1.89 milionë kuna, përafërsisht 252,000 Euro, me 72 projekte letrare të financuara.

Egjipti përllogaritet se ka humbur përafërsisht 12% të GDP-së qysh nga ndërprerja e turizmit në fillim të pandemisë, humbje kjo e përllogaritur në 17.6 bilionë dollarë vetëm për vitin 2020. Megjithatë, kjo e ka motivuar edhe më shumë Ministrinë Turizmit dhe Kulturës për të shpenzuar miliardë paundë kundrejt rijetëzimit të siteve arkeologjike dhe hapjes së muzeumeve të reja, duke bërë çdo gjë që ky kontribut t'i rikthehet edhe më shumë në ekonominë e vendit sapo izolimet të përfundojnë.²⁸


Suedia ka bërë një investim historik në kulturë, duke shtuar plus 3.4 bilionë²⁹ SEK për vitin 2020-2021. Gjermania miratoi në 2020ën buxhetin më të lartë, 2.1

²⁶ Republika e Kroacisë, Ministria e Kulturës dhe Medias. The Government of the Republic of Croatia adopted a series of measures to assist the cultural sector in order to minimize the adverse effects of the COVID-19 pandemic. Burimi: <https://min-kulture.gov.hr/government-of-the-republic-of-croatia-adopted-a-series-of-measures-to-assist-the-cultural-sector-in-order-to-minimise-the-adverse-effects-of-the-covid-19-pandemic/19501>

²⁷ Total Croatia News. Culture Ministry Allocates €533k for Visual Arts and €252k for Translations. 22.01.2022. Burimi: <https://www.total-croatia-news.com/news/59545-culture-ministry-allocates-533k-for-visual-arts-and-252k-for-translations>

²⁸ MENA. "Egypt is spending billions to preserve and promote its cultural heritage, minister says." Shkurt 18, 2022. Burimi: <https://www.thenationalnews.com/mena/egypt/2022/01/19/egypt-is-spending-billions-to-preserve-and-promote-its-cultural-heritage-minister-says/>

²⁹ Kunstkritykk Nordic Art Review. "Sweden makes historic investment in Culture." Shtator 11, 2020. Burimi: <https://kunstkritykk.com/sweden-makes-historic-investment-in-culture/>



bilionë euro buxhet kulturor.³⁰ Sektori kulturor në Angli do të marrë 850 milionë paund britanikë fond shtesë nga Thesari, si mënyrë për të ringjallur kulturën pas pandemisë.³¹

Komisioni European shtoi me gati 100 milionë euro më shumë buxhetin për 'Creative Europe' për vitin 2022, duke e rumbullakosur buxhetin në afërsisht 385 milionë euro.³²

Buxheti rekord për kulturën në botë momentalisht e ka Franca me një buxhet vjetor prej 4 bilionë eurosh, me një rritje prej 7.5% nga buxheti i vitit paraardhës. Ministrja Franceze e Kulturës, Roselyne Bachelot u shpreh se kjo është një rritje e paprecedentë, që përfaqëson Presidentin Makron dhe qeverinë e tij të dedikuar ndaj kulturës qysh nga viti 2017.³³

³⁰ Artnet news. "In a year of unprecedented financial strain, Germany has approved a €2.1 billion Culture Budget – Its largest ever." Nëntor 30, 2020. Burimi: <https://news.artnet.com/art-world/germany-culture-budget-2021-1927268>

³¹ Harris, Gareth. "England's culture sector to receive £850m in extra funding from Treasury." The Art Newspaper. Tetor 25, 2021. Burimi: <https://www.theartnewspaper.com/2021/10/25/englands-culture-sector-to-receive-pound850m-in-extra-funding-from-treasury>

³² Komisioni European. "Creative Europe: Increased budget in 2022 to support cultural and creative sectors." Janar 13, 2022. Burimi: https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_22_286

³³ ArtReview. "We saved Culture': France boosts 2022 culture budget to 4 billion euros." Shtator 30, 2021. Burimi: <https://artreview.com/we-have-saved-culture-france-boosts-2022-culture-budget-to-4-billion-euros/>

► REKOMANDIME



Qeveria shqiptare gjatë vitit të ardhshëm duhet të mundësojë kalimin e pragut 1% të buxhetit në fushën e kulturës, dhe të synojë minimalisht financimin e politikave kulturore shtetërore me 2% të prodhimit të brendshëm bruto.



Të krijohet një fond shtesë për lëmin kulturor, që të mundësojë lehtësimin dhe rikuperimin e pasojave afatgjata që pandemia ka shkaktuar në këtë sektor. Institucionet kulturore duhet të tregojnë ndjeshmëri dhe përgjegjshmëri në qasjen e tyre kundrejt rrjeteve artistike, të cilët kanë qenë shumë të izoluar në hapësirat e ndërveprimit të tyre si komunitet artistik, duke prekur financat e tyre, marrëdhëniet e tyre profesionale, si dhe shkëmbimet kulturore dhe artistike.



Mbi të gjitha, mosmbështetja me paketa financiare përgjatë pandemisë, dhe ndikimi që izolimi pati në krijimtarinë e tyre artistike dhe impaktin e tyre si krijues, ka lënë një njollë në shëndetin mendor të artistëve, duke shkaktuar stres dhe depresion të vazhdueshëm. Këshillohet që institucionet të shqyrtojnë me kujdes ndikimin që politikat e tyre mund të kenë tek artistët.



Të rritet niveli i transparencës financiare të institucioneve kundrejt qytetarëve. Ministria e Kulturës duhet të rrisë nivelin e llogaridhënies përkundrejt publikut, duke publikuar në mënyrë të detajuar shpenzimet e përlllogaritura.



Të kryhen studime shkencore në lidhje me impaktin e politikave kulturore. Suksesi ose mosesuksesi i tyre duhet të jetë i matshëm dhe i hapur për publikun. Ministria dhe institucionet e linjës duhet të justifikojnë mirëqeverisjen.



► Bibliografia

Raporte

INSTAT. “*Statistika të Kulturës, 2020.*” Burimi:

<http://www.instat.gov.al/media/8573/statistika-te-kultures-2020.pdf>

Kern, Philip. “*Një Strategji Kulturore për Shqipërinë. Vendosja/Mbjellja e çimkës kulturore.*” [Titulli në origjinal: *A Cultural Strategy for Albania. Implanting the Cultural Bug.*]. Këshilli i Europës. Mars, 2018. Burimi: <https://rm.coe.int/a-cultural-strategy-for-albania-implanting-the-cultural-bug/1680794665>

Kontrolli i Lartë i Shtetit. “Raport Përfundimtar Auditimi për auditimin e ushtruar në ‘Institutin e Monumenteve të Kulturës. Maj 2020.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë. “*Buxheti 2022. Një vështrim për qytetarët*”. Burimi: <https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/Buxheti-per-Qytetaret-2022.pdf>

Ministria e Kulturës. “*Kultura 2013-2017. Facts and Figures.*” Korrik, 2017. Burimi: https://issuu.com/min_kultures/docs/layout_albiona

Ministria e Kulturës. “*Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025*”. Burimi: <https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/finale-Strategjia-Komb%C3%ABtare-p%C3%ABr-Kultur%C3%ABn-2019-2025.pdf>

Ministria e Kulturës. “*Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025.*” Burimi: <https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2019/09/Strategjia-Komb%C3%ABtare-p%C3%ABr-Kultur%C3%ABn-2019-2025.pdf> Fq. 16-17.

UNESCO. “*Culture 2030 Indicators.*” Burimi:

http://uis.unesco.org/sites/default/files/documents/publication_culture_2020_indicators_en.pdf

Dokumente zyrtare

Ministria e Kulturës. “*Lista e 185 Fituesve të Thirrjes për Projekt-Propozime 2022.*” Burimi: <https://drive.google.com/file/d/1uZTFBGA45ZkIk9ep1BOoHmWjMkBILE2i/view>

Ministria e Kulturës. “*Detajimi i Buxhetit të Vitit 2022 për Institucionet e Varësisë të MK.*” Burimi: https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2020/05/Detajim-Buxheti-Korrente-2022_MK.pdf

Skena e Pavarur Kulturore dhe Ministria e Kulturës. “*Memorandum Mirëkuptimi midis Skenës së Pavarur Kulturore – SPK dhe Ministrisë së Kulturës për Bashkëpunimin dhe Konsultimin Paraprak për Ndryshimet në Ligjin Nr. 10352, Datë 18.11.2010 ‘Për Artin dhe Kulturën’ i Ndryshuar. Protokolluar: Nr. 2529, Dt. 13.04.2018.*”

Skena e Pavarur Kulturore, “*Manifest për Kulturën i Skenës së Pavarur Kulturore*”. 2018.

Akte normative

Këshilli i Ministrave. “*Vendim Nr. 507, Datë 13.09.2017, Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Kulturës.*” Burimi: <https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/VKM-per-fushen-e-pergjegjesise-se-Ministrise-se-Kultures.pdf>

Artikuj të publikuar në media

Bashkimi Europian

Komisioni Europian. “*Creative Europe: Increased budget in 2022 to support cultural and creative sectors.*” Janar 13, 2022. Burimi: https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_22_286



<https://news.artnet.com/art-world/eu-next-generation-culture-bailout-1872966>

Bosnje dhe Hercegovinë

http://www.fbihvlada.gov.ba/english/ministarstva/kultura_sport.php

Bota

<https://www.nytimes.com/2021/01/13/arts/coronavirus-pandemic-arts-support.html>

Egjipt

MENA. “Egypt is spending billions to preserve and promote its cultural heritage, minister says.” Shkurt 18, 2022. Burimi:

<https://www.thenationalnews.com/mena/egypt/2022/01/19/egypt-is-spending-billions-to-preserve-and-promote-its-cultural-heritage-minister-says/>

Francë

ArtReview. “‘We saved Culture’: France boosts 2022 culture budget to 4 billion euros.” Shtator 30, 2021. Burimi: <https://artreview.com/we-have-saved-culture-france-boosts-2022-culture-budget-to-4-billion-euros/>

<https://www.euronews.com/culture/2021/09/22/france-announces-2022-culture-budget-exceeds-4-billion-euros>

<https://www.dw.com/en/fact-check-spending-on-arts-and-culture/av-40645178>


Holandë

<https://dutchculture.nl/en/news/understanding-funding-for-international-cultural-cooperation>

Gjermani

Artnet news. “In a year of unprecedented financial strain, Germany has approved a €2.1 billion Culture Budget – Its largest ever.” Nëntor 30, 2020. Burimi:

<https://news.artnet.com/art-world/germany-culture-budget-2021-1927268>



Artnet news. “Germany is boosting its culture budget by \$140 million next year – Bringing the Ministry’s total spend to \$2.2 Billion.” Shtator 24, 2020. Burimi:

<https://news.artnet.com/art-world/germany-culture-budget-1910382>

Kosovë

Kallxo. “Mbi katër milionë euro më pak buxhet për MKRS-në, në krahasim me vitin 2020.” Nëntor 01, 2021. Burimi: <https://kallxo.com/lajm/mbi-kater-milione-euro-me-pak-buxhet-per-mkrs-ne-ne-krahasim-me-vitin-2020/>

KosovaPress. “Çeku bën bilancin e 2021: Rritëm buxhetin për trashëgiminë kulturore dhe sportin.” Dhjetor, 2021. Burimi: <https://kosovapress.com/ceku-ben-bilancin-e-2021-s-rritem-buxhetin-per-trashegimine-kulturore-dhe-sportin/>

https://www.institutigap.org/documents/31153_Ndikimi%20i%20pandemis%C3%AB%20ne%20Buxhet.pdf

<https://www.koha.net/kulture/212727/kultura-ne-kosove-me-nje-milion-euro-me-pak-ne-planet-e-qeverise-per-buxhetin/>

http://www.forumikulturor.net/repository/docs/Debat_Zhvillimi_kulturor_ne_Kosove.pdf

<https://www.kultplus.com/tag/buxheti/>

<https://kallxo.com/komuna/analize-komuna/tallja-e-ministrise-se-kultures-me-pavaresine-financiare-te-institucioneve-kulturore/>

<https://www.kosova-sot.info/kulture/162102//>



Raporti i 2020 për Kosovën: <https://ask.rks-gov.net/media/6448/kultura-2020.pdf>

Strategjia Kombëtare https://mkrs-ks.org/repository/docs/shqip_strategjia_per_trashegimi.pdf

http://www.forumikulturor.net/repository/docs/Politikat_kulturore_dhe_Ndarja_buxhetore.pdf

https://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2021/07/RaportiAuditimit_MKRS_2020_Shqip.pdf

<https://ndertimi.info/ministrise-se-kultures-i-projektohet-zbritja-e-buxhetit-per-6-milione-euro/>

<https://www.arbresh.info/kulture/ministri-gashi-premton-rritje-te-buxhetit-te-qendres-kinematografike-te-kosoves/>

[https://www.institutigap.org/documents/42354_AnalizaperbuxhetinSHQIPfinal%20\(1\).pdf](https://www.institutigap.org/documents/42354_AnalizaperbuxhetinSHQIPfinal%20(1).pdf)

<https://www.arbresh.info/kulture/ministri-gashi-premton-rritje-te-buxhetit-te-qendres-kinematografike-te-kosoves/>

[https://www.institutigap.org/documents/42354_AnalizaperbuxhetinSHQIPfinal%20\(1\).pdf](https://www.institutigap.org/documents/42354_AnalizaperbuxhetinSHQIPfinal%20(1).pdf)

Kroacia

Republika e Kroacisë, Ministria e Kulturës dhe Medias. The Government of the Republic of Croatia adopted a series of measures to assist the cultural sector in order to minimize the adverse effects of the COVID-19 pandemic. Burimi: <https://min-kulture.gov.hr/government-of-the-republic-of-croatia-adopted-a-series-of-measures-to-assist-the-cultural-sector-in-order-to-minimise-the-adverse-effects-of-the-covid-19-pandemic/19501>

Total Croatia News. Culture Ministry Allocates €533k for Visual Arts and €252k for Translations. 22.01.2022. Burimi: <https://www.total-croatia-news.com/news/59545-culture-ministry-allocates-533k-for-visual-arts-and-252k-for-translations>

Maqedonia e Veriut

Probiznes. “Buxheti për kulturën i Maqedonisë 3 herë më lartë se ai i Shqipërisë.” Shkurt 28, 2019. Burimi: <https://probiznes.al/buxheti-per-kulturen-i-maqedonise-3-here-me-larte-se-ai-i-shqiperise/>

KDPolitik. “Maqedoni e Veriut: A do të rikuperohet kultura pas pandemicë?” Janar 05, 2022. Burimi: <https://kdpolitik.com/2022/01/05/maqedoni-e-veriut-a-do-te-rikuperohet-kultura-pas-pandemise/>

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. “Stefoska: Buxheti i Kulturës në vitin 2021 është real, i përshtatur rrethanave dhe i projektuar sipas kushteve të Kovidit.” Nëntor 26, 2021. Burimi: <https://vlada.mk/node/23344?ln=sq>

Mbretëria e Bashkuar

Harris, Gareth. “England’s culture sector to receive £850m in extra funding from Treasury.” The Art Newspaper. Tetor 25, 2021. Burimi: <https://www.theartnewspaper.com/2021/10/25/englands-culture-sector-to-receive-pound850m-in-extra-funding-from-treasury>

Shqipëri

Agjencia Telegrafike e Lajmeve. “Margariti për projektet në buxhetin 2022: Prioritet Teatri i ri.” Nëntor 02, 2021. Burimi: <https://ata.gov.al/2021/11/02/margariti-per-projektet-ne-buxhetin-2022-prioritet-teatri-i-ri/>

Shqiptarja.com. “Si ndahet buxheti 2022 mes institucioneve? Shëndetësia merr pjesën e luanit! Tkurren fondet për Infrastrukturën dhe Financat.” Tetor 27, 2021. Burimi: <https://shqiptarja.com/lajm/si-ndahet-buxheti-2022-mes-institucioneve-shendetesia-merr-pjesen-e-luanit-tkurren-fondet-per-infrastrukturen-dhe-financat>

Sot. “Artistët përballë Kumbaros dhe Margaritit, kërkojnë rritje buxheti për artin e kulturën, status për universitetin dhe rikthim të QKA.” Janar 12, 2019. Burimi: <https://sot.com.al/kultura/artistet-perballe-kumbaros-dhe-margaritit-kerkojne-rritje-buxheti-artin-e-kulturen-status>

Sot. “Shqipëria e fundit në Europë në buxhet për artin, SPK propozon rritje fondesh, krijim të QKA dhe regjistrin për IKK. Shkurt 25, 2021. Burimi: <https://sot.com.al/kultura/shqiperia-e-fundit-ne-europe-ne-buxhet-per-artin-spk-propozon-rritje-fon-i425695>

Suedi

Kunstkritikk Nordic Art Review. “Sweden makes historic investment in Culture.” Shtator 11, 2020. Burimi: <https://kunstkritikk.com/sweden-makes-historic-investment-in-culture/>

Intervista

Kurti, Ilda. Intervistë me Andi Tepelenën, si menaxher kulture dhe përfaqësues i grupimit të organizatave kulturore jofitimprurëse Skena e Pavarur Kulture. 1 shkurt 2022.

Emisione televizive

Demo, Elsa. “Artes me Elsa Demo: Arti nën patronazh.” *Radio Televizioni Shqiptar*, YouTube video, 1:09:27. Shkurt 2, 2022. <https://www.youtube.com/watch?v=YYjtxj4fqjo> (aksesuar më 10 shkurt 2022).

Websites

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore. Link: <http://iktk.gov.al/site/informacion-mbi-buxhetin-dhe-te-dhenat-financiare-te-ap/>

Ministria e Kulturës. Link: <https://kultura.gov.al/programi-i-kultures-2019-2025/>

Skena e Pavarur Kulturore. Link: <https://www.spk.al/>

Foto

Ministria e Kulturës. “Foto e ministres Margariti.” Link: https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=317364217088861&id=100064458561129

Ministria e Kulturës. “Kultura 2022 Prioritet.” Link: <https://www.facebook.com/photo/?fbid=301323128692970&set=a.229475015877782>

Rrjete sociale

Ministria e Kulturës. Burimi: https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=317364217088861&id=100064458561129

SPK – Kkena e Pavarur Kulturore. Link: https://m.facebook.com/skenapavarurkulturore/posts/1431181666992126/?_rdr

SPK – Skena e Pavarur Kulturore. Link: <https://m.facebook.com/skenapavarurkulturore/photos/a.374295882680715/3459293224180950/?type=3>

#QENDRESE MIREQEVERISJE